



Statuti i Shoqërisë NOA Holding

Miratuar më 21/03/2023

Tabela e përmbajtjes:

Hyrje	3
KREU I - EMËRTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHËZGJATJA	3
KREU II - KAPITALI DHE KUOTA	5
KREU III - ORGANIZIMI I SHOQËRISË	6
KREU IV - VENDIMMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË	7
KREU V - DISPOZITAT E FUNDIT	111

Hyrje

Sot më 01/03/2023 unë i nënshkruari:

- Gentian Sula, i datëlindjes 09.03.1983, lindur në Burrel, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B,

me qëllim themelimin dhe regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, miratoj Statutin e **NOA Holding Sh.p.k.**, në përputhje me legjislacionin shqiptar, vullnetin e shprehur në vendimin e themelimit dhe dispozitat si më poshtë.

KREU I EMËRTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHËZGJATJA

Neni 1

Forma dhe Emërtimi

- 1.1 Shoqëria ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Emërtimi i shoqërisë është **NOA Holding Sh.p.k.** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).
- 1.3 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar (në vijim referuar si “**Ligji Tregtar**”), legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:
“Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Shqipëri”.
- 2.2 Shoqëria mund të krijojë degë, seli dytësore dhe të zhvillojë aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Administratorit/ëve.

Neni 3

Objekti i Shoqërisë

- 3.1 Shoqëria e cila ka organizimin si një shoqëri *Holding*, do të jetë zotëruese e kuotave në disa shoqëri të tjera dhe do të ofrojë asistencë për shoqëritë e zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë Shoqëria apo ortaku i saj (në vijim referuar si “**Shoqëritë e Grupit**”). Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj ushtrimin e aktiviteteve, që do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në sa më poshtë:
 - a. Koordinimin teknik, administrativ, financiar dhe organizativ i gjithë Shoqërive të Grupit;
 - b. Orientimin në vendosjen e objektivave dhe strategjive, koordinimin e aktiviteteve, vendosjen e objektivave financiare, kontrollin e sjelljes dhe efektivitetit financiar dhe në përgjithësi, menaxhimin dhe kontrollin financiar si dhe mbështetjen në këtë drejtim të Shoqërive të Grupit;

- c. Këshillimin e vazhdueshëm për aktivitetet tregtare, që do të përfshijë por nuk do të kufizohet në studime dhe asistencë për themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve tregtare në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin mbi shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë, asistencë në hartimin e statuteve, mbajtjen e librave të shoqërive tregtare dhe përmbushjen e detyrimeve pranë organeve përkatëse, asistencë në përgatitjen e planeve të biznesit, asistencë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të ristrukturimit dhe uljes së kostove, asistencë në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ekonomike të jashtëzakonshme të shoqërive (ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje sipërmarrjesh ose degësh të tyre; transformime, mbyllje dhe likuidim të shoqërive);
- d. Këshillimin financiar duke përfshirë por pa u kufizuar në analizën financiare për strategjitë e zhvillimit, përgatitjen e planeve të financimit, këshillim dhe asistencë në operacionet e kredisë, studim dhe kërkim burimesh financiare me kushte lehtësuese, asistencë në operacionet e investimeve të paluajtshme, dhe fusha të tjera;
- e. Suport në çështje në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe çdo element tjetër për infrastrukturën e nevojshme për realizimin e aktivitetit për secilën nga Shoqëritë e Grupit;
- f. Këshillim dhe orientim strategjik në menaxhimin e kapitalit njerëzor në për secilën nga Shoqëritë e Grupit në përputhje me strategjinë e Grupit si dhe dhënien e shërbimeve të burimeve njerëzore në për secilën nga Shoqëritë e Grupit në fushën e buxhetimit, planifikimit, rekrutimit dhe punësimit, përputhshmërisë, analizave dhe metrikave të burimeve njerëzore, menaxhimit të performancës, të karrierës dhe zhvillimit profesional (trajnitimit), sistemit të pagave dhe shpërblimeve, marrëdhënieve me punonjësit, menaxhimin e largimeve e të tjera, sipas akteve të brendshme të miratuara nga Ortaku i Vetëm;
- g. Asistencë në lidhje me politikat dhe planet për menaxhimin e riskut;
- h. Dhënien e shërbimeve të analizës, studimeve të tregut dhe marketingut për çështje që lidhen me aktivitetin e Shoqërive të Grupit;
- i. Dhënien e garancive të të gjitha llojeve për secilën nga Shoqëritë e Grupit; dhe
- j. Çdo shërbim tjetër në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të vetë shoqërisë NOA Holding dhe Shoqërive të Grupit.

3.2 Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1** Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2** Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.
- 4.3** Shoqëria mund të prishet gjithashtu për shkaqe ligjore, të pavarura nga vullneti i Ortakut të Vetëm.

KREU II KAPITALI DHE KUOTA

Neni 5

Kapitali

5.1 Kapitali i Shoqërisë është krijuar përmes kontributit në kapital të:

- 100% të kuotave të kapitalit të **NOA Control**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L51622005C, me kapital në shumën 100.000,00 *(një qind mijë)* Lekë i përbërë nga një kuotë me vlerë 100.000,00 *(një qind mijë)* Lekë dhe të zotëruar tërësisht nga Z. Gentian Sula;
- 100% të kuotave të kapitalit të **NOA Energy Trade**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L42203031A, me kapital në shumën 431.293.021,00 *(katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një)* Lekë i përbërë nga një kuotë me vlerë 431.293.021,00 *(katërqind e tridhjetë e një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një)* Lekë dhe të zotëruar tërësisht nga Z. Gentian Sula;
- 100% të kuotave të kapitalit të **NOA Development**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L42203032I me kapital në shumën 174.600.000,00 *(njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind mijë)* Lekë i përbërë nga dy kuota me vlerë totale 174.600.000,00 *(njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind mijë)* Lekë dhe të zotëruara në 99.94% nga shoqëria Zip Cloud Sh.p.k. dhe 0.06% nga Z. Gentian Sula.
- 100% të kuotave të kapitalit të **Zip Cloud**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L61531022M me kapital në shumën 100.000,00 *(një qind mijë)* Lekë i përbërë nga një kuotë me vlerë 100.000,00 *(një qind mijë)* Lekë dhe të zotëruara tërësisht nga Z. Gentian Sula.
- 100% të kuotave të kapitalit të **KISS FM**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K92226026O me kapital në shumën 5.000.000,00 *(pesë milion)* Lekë i përbërë nga një kuotë me vlerë 5.000.000,00 *(pesë milion)* Lekë dhe të zotëruara tërësisht nga Z. Gentian Sula.

5.2 Kuotat e mësipërme përfshihen si kontribut në kapital me vlerën e tyre nominale siç pasqyrohen në datën e nënshkrimit të këtij dokumenti në Regjistrin Tregtar.

5.3 Në përputhje me pikën 5.1 më sipër kapitali i Shoqërisë është 611.093.021,00 *(gjashtëqind e njëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një)* Lekë, i përbërë vetëm nga 1 *(një)* kuotë, e zotëruar tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

Neni 6

Ortaku i Vetëm

6.1 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- **Z. Gentian Sula**, i datëlindjes 09.03.1983, lindur në Burrel, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar në shumën prej 611.093.021,00 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e tre mijë e njëzet e një)Lekë.

6.2 Ndryshimet në ortakërinë e Shoqërisë regjistrohen në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 7.2 Shoqëria në çdo kohë mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e vlerës së kapitalit të kërkuar nga Ligji Tregtar.
- 7.4 Kontributi i mëtëjshëm i Ortakut të Vetëm në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, kuota apo të drejta). Mënyra e shlyerjes së kontributeve do të përcaktohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 8

Transferimi i kuotës

- 8.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për pjesëtimin dhe transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 8.2 Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet përcaktohen në momentin e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, momentin e pagesës së çmimit, në kontratën e kalimit të kuotës, e cila hartohet në formë shkresore, sipas dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm.

KREU III ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 9

Organet e Shoqërisë

9.1 Organet e Shoqërisë janë si vijon:

- Ortaku i Vetëm – organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori/ët – organi më i lartë ekzekutiv;
- Bordi Këshillues - organ këshillues lidhur me mbarëvajtjen e Shoqërisë;
- Sekretari i Holding - organ për lehtësimin e komunikimit ndërmjet organeve të tjera.

9.2 Ortaku i Vetëm mund të krijojë organe apo struktura të tjera ndihmëse për mbarëvajtjen e Shoqërisë.

Neni 10 **Rregulloret e Brendshme**

10.1 Në përputhje me rregullat, procedurat dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm, Ortaku i Vetëm miraton rregullore të posaçme për organizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

10.2 Rregulloret e përmendura në pikën 10.1 përfshijnë por pa u kufizuar:

- a. Rregulloren për administrimin e shoqërive;
- b. Parashikimet për parandalimin e konfliktit të interesit;
- c. Kodin e etikës etj.

(“Rregulloret”)

KREU IV **VENDIMMARRJA DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Neni 11 **Vendimmarrja**

11.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.

11.2 Ortaku i Vetëm merr vendime për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat e Shoqërisë, në çdo moment.

11.3 Ortaku i Vetëm është përgjegjës, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave të Shoqërisë;
- b. ndryshimin, modifikimin, plotësimin e statutit dhe akteve të tjera të Shoqërisë;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, vendosjen dhe ndarjen e kompetencave të tyre, si dhe shpërblimin përkatës;
- d. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e. emërimin dhe shkarkimin e audituesit ligjor dhe likuiduesve dhe shpërblimin e tyre;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- g. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
- h. pjesëtimin dhe transferimin e kuotës;
- i. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- j. shpërndarjen e fitimeve;
- k. riorganizimin, prishjen dhe/ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
- l. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm, ky Statut apo rregulloret e përmendura në nenin 10 të këtij Statuti.

Neni 12

Regjistri i Vendimeve

- 12.1** Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 12.2** Duhet të regjistrohen në veçanti, vendimet e mëposhtme:
- a. miratimi i pasqyrave financiare dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b. shpërndarja e fitimeve dhe humbjeve;
 - c. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
 - d. vendime në lidhje me investimet;
 - e. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.
- 12.3** Lista e mësipërme nuk është shteruese. Vendime të tjera të Ortakut të Vetëm mund të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve.
- 12.4** Vendimet të cilat nuk regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Gjithsesi, Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 13

Administrimi

- 13.1** Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë, numri dhe kompetencat e të cilëve do të përcaktohen me vendim nga Ortaku i Vetëm.
- 13.2** Administratori i parë i Shoqërisë është:
- 13.3** *Znj. Kledia Stefani, lindur më 02.09.1985, në Tiranë, mbajtëse e pasaportës me numër personal I55902072K.*
- 13.4** Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 13.5** Administratori/ët zgjidhen në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufizimet e Ligjit Tregtar.
- 13.6** Administratorët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë.
- 13.7** Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar.
- 13.8** Kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm, pa kufizim.
- 13.9** Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Ortakut të Vetëm, i cili duhet të caktojë një administrator të ri apo të ndajë kompetencat ndërmjet administratorëve të mbetur (në rastin kur Shoqëria ka disa administratorë).
- 13.10** Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e Shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas legjisllacionit të zbatueshëm.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Administratorët janë përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësojnë Shoqërinë me palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, Rregulloret, vendimet e Ortakut të Vetëm dhe legjislationin e zbatueshëm.
- 14.2** Kompetencat dhe detyrat e administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- zbatimin e politikave dhe vendimeve të Ortakut të Vetëm;
 - kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e Shoqërisë;
 - sigurimin e mirëmbajtjes së rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
 - sigurimin e përputhshmërisë me Ligjin e Zbatueshëm dhe standardet e kontabilitetit nga Shoqëria;
 - përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat paraqiten përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
 - raportimin përpara Ortakut të Vetëm dhe Bordit Këshillues në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - njoftimin e menjëhershëm të Ortakut të Vetëm për çdo çështje që kërkon vendimmarrjen e tij;
 - kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, në regjistrin tregtar dhe pranë çdo institucion tjetër sipas kërkesave të Ligjit të Zbatueshëm;
 - krijimin e një sistemi paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë dhe menaxhimin e efektshëm të Shoqërive të Grupit;
 - pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Bordit Këshillues;
 - kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në Ligjin e Zbatueshëm, statutin dhe Rregulloret e Shoqërisë.
- 14.3** Ortaku i Vetëm përcakton, me vendim përkatës dhe në Rregullore, kufizimet e kompetencave, objektin e kompetencave për secilin administrator dhe, nëse është e nevojshme, procedurat për mbledhjet e administratoreve.
- 14.4** Në rast caktimi të më shumë se një administratori, Ortaku i Vetëm përcakton me vendim ndarjen e kompetencave ndërmjet tyre, kompetencat të cilat ushtrohen veçmas dhe kompetencat të cilat ushtrohen bashkërisht nga më shumë se një administrator.
- 14.5** Ndryshimet dhe kufizimet në administrimin e Shoqërisë si më sipër, nuk do të jenë konsiderohen si ndryshim i statutit të Shoqërisë.
- 14.6** Administratori mund të veprojë vetëm duke marrë parasysh interesin më të lartë të Shoqërisë.
- 14.7** Administratori mund të delegojë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tij tek persona të tjerë.

- 14.8** Administratorët informojnë Ortakun e Vetëm për ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vërë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë, raportet e organeve drejtuese apo të audituesit ligjor, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të Shoqërisë.
- 14.9** Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis dhe ruajtjes së informacionit konfidencial, të ushtrojnë kompetencat që u njihen në legjislacionin e zbatueshëm ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në dispozitat e Ligjit Tregtar, të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim, të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë, të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 14.10** Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas parashikimeve të këtij Statuti, rregulloreve të posaçme të miratuara nga Ortaku i Vetëm dhe nga legjislacioni i zbatueshëm, ata janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
- 14.11** Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

Neni 15

Bordi Këshillues

- 15.1.** Bordi Këshillues është një organ kolegjal, i cili jep mendime këshillimore dhe monitoron aktivitetin e Shoqërisë dhe të gjitha Shoqërive të Grupit.
- 15.2.** Funksionimi, kompetencat dhe detyrat e Bordit Këshillues përcaktohen në Rregullore dhe në vendimet e Ortakut të Vetëm.
- 15.3.** Bordi Këshillues apo anëtarët e tij nuk mund të ushtrojnë në asnjë rast kompetenca që Ligji Tregtar u rezervon Administratorit/ëve apo Ortakut të Vetëm.

Neni 16

Sekretari i Holding

- 16.1** Ortaku i Vetëm cakton një Sekretar të Shoqërisë, i cili shërben si urë komunikimi ndërmjet Bordit Këshillues, Administratorit/ëve dhe Ortakut.
- 16.2** Kompetencat, detyrat dhe kohëzgjatja e mandatit të kryetarit të Sekretarit të Holding, përcaktohen në Rregullore dhe në vendimet e Ortakut të Vetëm.

KREU V
DISPOZITAT E FUNDIT**Neni 17****Audituesi Ligjor**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'u besohet një audituesi ligjor.

Neni 18**Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare**

- 18.1** Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 18.2** Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe audituesit ligjor, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me Ligjin Tregtar.

Neni 19**Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë**

- 19.1** Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj, sipas dispozitave të Ligjit Tregtar.
- 19.2** Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund t'i shkarkojë apo zëvendësojë në të njëjtat kushte.
- 19.3** Administratori/ët i Shoqërisë i njofton për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar Shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse.
- 19.4** Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
- 19.5** Nëse Shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
- 19.6** Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
- 19.7** Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se 1 (një) vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 19.8** Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjate kësaj procedure, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 20**Të dhëna të detyrueshme gjatë kohëzgjatjes së Shoqërisë**

- 20.1** Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga Shoqëria, degët apo zyrat eventuale të përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
- numrin unik të identifikimit;
 - formën ligjore të shoqërisë;
 - vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit.
- 20.2** Nëse Shoqëria krijon edhe një faqe interneti, këto të dhëna do të pasqyrohen aty.

Neni 21**Ligji i Zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 21.1** Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 21.2** Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, e në veçanti ato të Ligjit Tregtar.
- 21.3** Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM I “NOA HOLDING SH.P.K.”

Gentian Sula

